

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Institucionet financiare ndërkombëtare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti IV, Semestri II (Moduli financiar)
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla A3
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Mejd Bektashi Prof.Ass.Dr. Artor Nuhiu
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:meidi.bektashi@uni-pr.edu">meidi.bektashi@uni-pr.edu</a> <a href="mailto:artor.nuhiu@uni-pr.edu">artor.nuhiu@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<i>Studimi i lëndës “Institucionet Financiare Ndërkombëtare” ka të bëjë me të kuptuarit e filleve të ndërtimit dhe jetësimit të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare në periudha të mëhershme dhe se vetëm pas Luftës së II Botërore vendimarrësit në nivele globale kuptuan se ruajtja e paqës, sovranitetit të shteteve dhe mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe sociale në çdo pjesë të rruzullit tokësor nuk mund të ruhet përmes ndikimit politik ose atij ideologjik apo kërcnimeve militare, por vetëm përmes funksionalizimit të institucioneve të fuqishme ekonomike dhe financiare.</i>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<i>Qëllimi i studimit të kësaj lënde shumë aktuale është që studentëve të studimeve bachelor të i’u ofrojë njohuri thelbësore e të mjaftueshme por njëkohësisht dhe aktuale lidhur me proceset financiare si dhe rolin e këtyre institucioneve në proceset e sotme globale, e posaçërisht në periudhat e krizave globale ekonomike dhe financiare që dekadave të fundit po paraqiten shumë shpeshë.</i>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<i>Aftësitë dhe shkathtësitë që do t’i fitojnë studentët pas përfundimit të sukseshëm të kësaj lënde, është që:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Të kuptojnë se fillet e ndërtimit dhe jetësimit të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare ishte i periudhave më të hershme dhe se vetëm pas Luftës së II Botërore vendimarrësit në nivele globale kuptuanë se ruajtja e paqës, sovranitetit të shteteve dhe mirëqenja e përgjithshme ekonomike dhe sociale në çdo pjesë të rruzullit tokësor nuk mund të ruhet përmes ndikimit politik</i></li> </ul>

	<p><i>ose ati idelogjik apo kërcnimeve militare, por vetëm përmes funksionalizimit të institucioneve të fuqishme ekonomike dhe financiare;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Të kuptojnë qëllimin e formimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, rëndësinë e marrëveshjes së Bretenvudsit për zhvillimin e shteteve të shkatërruara nga Lufta e II Botërore, si dhe rëndësia e këtyre organizatave që veprojnë në kuadër të OKB-së për ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe zhdukjes së varfërisë në botë;</i></li> <li>• <i>Të kuptojnë thelbin dhe rëndësinë e themelimit dhe evaluimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Organizatës Botërore të Tregtisë, si institucione që për një kohë të shpejtë dhe në thelb ndryshuan mënyrën e të menduarit si të vendimarrësve në fushën e politikës ekonomike ashtu edhe të atyre nga fusha politike;</i></li> <li>• <i>Të formësojnë bindjen se funksionimi i këtyre Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, nuk ishte gjithnjë i mirëpritur nga ana e disa shteteve, grupeve të caktuara të interesit, apo edhe të disa nobelistëve të mirënjohur nga fusha e ekonomisë që gjithnjë e më shumë kritikojnë mënyrën e funksionimit dhe efektet e pritura nga këto institucione;</i></li> <li>• <i>Të kuptojnë se përveç funksionimit të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare në nivelin global, momentalisht në kuadër të Unionit Evropian funksionojnë disa institucione financiare, që nuk kishin për qëllim veprimin global por ishin më tepër të fokusuara në shtetet ish- socialiste, dhe ate për financimin e zbatimit të reformave të ekonomisë së tregut, si dhe transformimin e tyre pronësor, por nga ana tjetër kishin dhe një ndikim shumë të rëndësishëm edhe në demokratizimin e ish – shteteve totalitare;</i></li> <li>• <i>Të kuptojnë problemet që janë paraqitur si rezultat i krizës globale financiare dhe si e njejta reflektohet në ekonomitë e ndryshme të botës;</i></li> <li>• <i>Përmes shpjegimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje që të kuptojnë se ku gjindet shteti i Kosovës dhe shtetet tjera të rajonit në proceset e ndryshme që shpeshë herë janë të ndërlidhuara me funksionimin e këtyre Institucioneve Financiare qofshin globale apo rajonale.</i></li> </ul>
--	--

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënërit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	4	16
Përgaditja përfundimtare për provim	6	2	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
<b>Totali</b>			<b>100 orë</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<i>Me ndihmën e ligjeratave, prezentimeve, seminarëve, punës në grupe, testëve dhe formave tjera të mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive gjatë gjithë semestrit, studentët aftësohen që në të ardhmën, në menyrë të pavarur dhe në cilësinë e ekspertit profesional t'i sfidojnë sfidat që paraqiten edhe në fushën e marrjes së vendimeve ekonomike, financiare dhe ato juridike.</i>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p><i>Vlerësimi i studentëve konsiston në dy metoda:</i></p> <p><b>1. Vlerësimi i vazhdueshëm:</b> Studentët do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit përmes dy vlerësimeve/kollokfiumeve semestrale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Vlerësimi/Kollokfiumi i parë: 45%</b> (fokusi në temat e ligjëratave nga javët 1-7).</li> <li>▪ <b>Vlerësimi/Kollokfiumi i dytë: 45%</b> (fokusi në temat e ligjëratave nga javët 9-14).</li> <li>▪ <b>Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata, angazhimi në diskutime dhe prezantimi: 10%.</b></li> </ul> <p><b>2. Provimi final:</b> Studentët që nuk kanë arritur të kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm ose nuk kanë marrë pjesë në të, duhet t'i nënshtrohen provimit final gjatë afatit të provimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Provimi final:</b> Vlerësohet me <b>100%</b> dhe mbulon të gjithë materialin e ligjëruar gjatë semestrit.</li> </ul> <p><b>Shënim:</b> Studentët që zgjedhin/kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm dhe janë të kënaqur/pranojnë notën e kollokfiumit lirohen nga pjesëmarrja në provimin final.</p>		

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Ligjërata të autorizuara, Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2023.</i></li> <li>2. <i>Frederic S, Mishkin dhe Stanley G. Eakins: Financijaska trzista + institucije, Zagreb, 2005.</i></li> <li>3. <i>Riçard Baldwin dhe Çarls Viploc: Ekonomia e Integrimin Evropian, Botimi i tretë, Ars Lamina, Shkup, 2012.</i></li> <li>4. <i>Michele Chang: Integrimi Monetar në Bashkimin Evropian, Universum Press, Prishtinë, 2013.</i></li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Vlatko Mileta : Leksikoni i Unionit Evropian, Prishtinë, 2006.</i></li> <li>2. <i>Joseph E. Stiglitz: Globalization and Its Discontents (Globalizimi dhe dilamat që i shkakton) Prishtinë, 2008.</i></li> <li>3. <i>Randy Charles Epping: Një guidë e ekonomisë botërore, Tiranë 2007.</i></li> <li>4. <i>Branislav Peleviq dhe Vladimir Vuckovic: Medjunarodna ekonomija, Bgd. 2007.</i></li> <li>5. <i>Alan Greenspan: Epoka e trazirave, Avantura në një botë të re, UETPres, Tiranë, 2012.</i></li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimin:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Ligjërata hyrëse- prezantimi i syllabusit të lëndës
<b>Java e dytë:</b>	Organizatave ekonomike para themelimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB); Lidhja e Kombeve; Organizata Ndërkombëtare e Punës; Oda Tregtare Ndërkombëtare. Organizata e Kombeve të Bashkuara; Qëllimet dhe parimet e OKB-së; Organet kryesore të OKB-së
<b>Java e tretë:</b>	Marrëveshja monetare e Bretton Woods; Plani i Uajtsit dhe Kejnstit; Fondi Monetar Ndërkombëtar – qëllimet parësore; Të drejtat speciale të tërheqjes; Organizimi; Kreditimi; Mbikëqyrja, Organet drejtuese të FMN-së; Kritikën më të shpeshta ndaj FMN; FMN dhe kritikën e Stiglitz-it. Grupi i Bankës Botërore; Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD); Kritikën më të shpeshta ndaj IBRD
<b>Java e katërt:</b>	Afilacionet e Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim; IDA (International Development Association)–Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim; IFC (International Financial Corporation)- Korporata Ndërkombëtare Financiare; MIGA-Agjencioni Multilateral për Garantimin e Investimeve (Multilateral Investment Guarantee Agency); International Centre for Settlement of Investment Disputes-Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve.
<b>Java e pestë:</b>	Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifa dhe Tregt (GATT), historiku, themelimi dhe funksionimi; Organizata Botërore e

	Tregtisë (OBT); Dallimi në mes GATT dhe OBT-së; Efektet e themelimit të OBT-së; Parimet e OBT-së; Funkcionet e OBT-së; Struktura organizative. Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë me Sherbime (GATS); Marrëveshja mbi aspekte të të drejtave të pronësisë intelektuale që lidhen me tregtinë (TRIPS); Parimet bazë të marrëveshjes TRIPS; Antarësimi në OBT; Kritikrat më të shpeshta ndaj OBT-së.
<b>Java e gjashtë:</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH); Qëllimet parësore dhe aktivitetet; Struktura organizative e BERZH-it; Kreditimi dhe politikat kreditore; Kritikrat më të shpeshta ndaj BERZH-it.
<b>Java e shtatë:</b>	Institucionet Financiare Rajonale; Banka Investive Evropiane (BIE); Varshmëria në mes të BE-së dhe BIE-së; BIE dhe Shtetet e Ballkanit Perendimor; Struktura organizative e BIE-së; Fondi Investiv Evropian; Banka Zhvillimore e Këshillit Evropianë.
<b>Java e tetë:</b>	<i>Vlerësimi/Kollokfiumi i parë</i>
<b>Java e nëntë:</b>	Banka Qendrore Evropiane (BQE); Si organizohet puna e Bankës Qendrore Evropiane? Unioni Monetar Evropian; Kriteret e Mastrohtit; Sistemi i Rezervave Federale (FED); SWIFT-Shoqata Botërore për telekomunikacionin financiar ndërbankar.
<b>Java e dhjetë:</b>	Banka Aziatike për Zhvillim; Banka Afrikane për Zhvillim; Banka Interamerikane për Zhvillim; Banka Arabe për Zhvillim; Banka Islamike për Zhvillim; Fondi Arab për Zhvillim Ekonomik dhe Shoqëror; Tregu i Përbashkët Arab.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Organizatave ekonomike të shteteve të zhvilluara; OECD - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik; Aktivitetet parësore të OECD-së; Organizimi i aktiviteve; OPEC (Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës); Kriza e naftës dhe pasojat; Klubi i Parisit; Klubi i Londrës; Grupi G7 dhe G8.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Shtetet anëtare të Grupit BRICS; Organizata Grupi G20; Asociacioni Evropian për Tregti të Lirë (EFTA); Zona e Tregtisë së Lirë të Amerikës Veriore (NAFTA); Marrëveshja për Tregti të Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (CEFTA); Unioni Ekonomik Euroaziatik.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Konkuzusi i Washingtonit; Format e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi; Rregullat dhe Rregullativa; Pozita dhe roli i Organizatave Ndërkombëtare Financiare.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Rëndësia e Institucioneve Financiare Ndërkombëtare. Kritikrat më të shpeshta për funksionimin dhe efektet e tyre; Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe Kosova; Mënyra e antarësimit; Efekti i tyre në zhvillimin e ardhshëm të Kosovës.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<i>Vlerësimi/Kollokfiumi i dytë</i>

### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

***Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:***

- *Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;*
- *Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);*
- *Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimi;*
- *Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.*

***Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:***

- *Kopjimi gjatë provimit ose testit;*
- *Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;*
- *Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;*
- *Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.*